



**Republika e Kosovës
Komuna e Drenasit
Kuvendi i Komunës**



Nr. 12 020-4123 dt. 26 01 2022

Bazuar në nenin 11, 12 dhe 40 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës"), nenit 34 pika 34.6 nënpika f të Statutit të Komunës së Gllogocit të aprovuar në vitin 2008, nenit 43 të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, nenit 35 paragrafi 35.1 të Ligjit nr. 02/L-123, për Shoqëritë Tregtare, Kuvendi i Komunës së Drenasit në mbledhjen e mbajtur me datë 26. 01.2022, miratoi këtë:

V E N D I M

Për formimin e komisionit për plotësim ndryshimin e Statutit Nr. 12-060/05-14928, të datës 30.04.2020 të Ndërmarrjes Publike Lokale "Stacioni i Autobusëve" në Drenas

Neni 1

Më këtë propozim vendim formohet komisioni për plotësim ndryshimin e Statutit Nr. 12-060/05-14928, të datës 30.04.2020 të Ndërmarrjes Publike Lokale "Stacioni i Autobusëve" Sh.A në Drenas, të cilin Komision e përbejnë një (1) anëtar nga Ekzekutivi i Komunës të cilin e propozon Kryetari i Komunës, dy (2) anëtar nga Kuvendi i Komunës:

1. Valmir Bajraktari- anëtar nga ekzekutivi;
2. Gani Krasniqi- anëtar nga kuvendi;
3. Mehedin Salihu - anëtar nga kuvendi.

Neni 2

Detyrë e komisionit komunal është që të bëjë plotësim ndryshimin e statutit të Ndërmarrjes Publike Lokale "Stacioni i Autobusëve" Sh. A në Drenas, duke e harmonizuar me projekt statutin e Ndërmarrjes Publike Lokale "Stacioni i Autobusëve" Sh. A të draftuar nga Asociacioni i Komunave të Kosovës, si dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 3

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë nga dita e regjistrimit dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga MPLsi dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi i dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit ;
- Drejtorisë Përkatëse;
- Zyrës së Kuvendit;
- Arkivit



Kryetari i Kuvendit të Komunës

Milaim Hajdari

Zahrie Podrimqaku

From: Vjosa Ahmetaj
Sent: Monday, February 7, 2022 11:16 AM
To: Milaim Hajdari
Cc: Besim Murtezani; Gëzim Sahiti; Zahrie Podrimqaku
Subject: Njoftim....

I nderuar,

Bazuar në Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, (shtojca II - Aktet e organeve të komunës që nuk i nënshtrohen shqyrtimit të detyrueshëm apo të rregullt të ligjshmërisë), Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal pas shqyrtimit të përmbajtjes së akteve të Komunës së Glllogocit, si në vijim:

Vendimi Nr. 12.020-4123 për formimin e komisionit për plotësim ndryshimin e Statutit Nr. 12-060/05—14928 të datës 30.04.2020 të Ndërmarrjes Publike Lokale "Stacioni i Autobusëve" në Glllogoc, vendim i datës 26.01.2022, vlerëson se akti i komunës nuk i nënshtrohet shqyrtimit të detyrueshëm të ligjshmërisë.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal mbetet në dispozicion të Komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejme në lidhje me këtë vlerësim.

Me respekt,
Vjosa Ahmetaj
Zyrtare e Lartë për Monitorim të Komunave
Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave – MAPL
Tel: +381 (0) 200 35 662
E-mail: vjosa.ahmetaj@rks-gov.net
Adresa: Pallati i Shtypit Ish-Rilindja